



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 prill 2020
Nr. Ref.:RK 1548/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI107/19

Parashtrues

Gafurr Bytyqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-19-0065,
të 6 qershorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Gafurr Bytyqi, me vendbanim në Komunën e Lipjanit, të cilin e përfaqëson Armend Deskaj, avokat (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [AC-I-19-0065] e 6 qershorit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS) në lidhje me Aktvendimin [C-I-19-0002] e 7 majit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar përmes të cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 10 [Ekonomia], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 42 [Liria e Medieve], 53 [Interpretimi i dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme, duke *“ndaluar shitjen e Njesisë nr. 37: Marketing Export Lokali Lipjan/Shitja e aseteve në valën 42”* (në tekstin në vijim: prona e kontestuar).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 20 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 11 korrik 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi dorëzimin e autorizimit për përfaqësim para Gjykatës.
9. Më 26 korrik 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e përgjithshëm të 19 dhjetorit 2018.

10. Më 31 korrik 2019, Gjykata përsëriti kërkesën për dokumente shitesë me njoftimin se në rast të mos sjelljes së autorizimit për përfaqësim para Gjykatës, kërkesa do të refuzohet në procedurë të shkurtë në bazë të paragrafit 5 të rregullit 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës.
11. Më 5 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës (i) dorëzoi autorizimin për përfaqësim në Gjykatë; dhe (ii) informoi Gjykatën se prona e kontestuar po ri-tenderohej përmes valës së 49, të shënuar me njësinë nr. 98 dhe në ditën e ofertimit të përcaktuar më 21 gusht 2019.
12. Më 4 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës paraqiti përsëri plotësim të kërkesës në Gjykatë, duke vënë theks në kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme për ndalimin e shitjes së pronës së kontestuar. Përmes kësaj shkrese, parashtruesi i kërkesës gjithashtu dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin [C-I-19-0008] e 20 gushtit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe përmes të cilit ishte miratuar kërkesa për nxjerrjen e urdhrit paraparak gjyqësor në një rast tjetër, por sipas parashtruesit të kërkesës në rrethana të njëjta me ato të tij, duke pretenduar para Gjykatës rrjedhimisht edhe shkelje të nenit 31 të Kushtetutës si pasojë e mungesës së konsistencës të praktikës gjyqësore të DHPGJS-së.
13. Më 14 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti plotësimin e radhës të kërkesës, ku e informon Gjykatën se, më 4 tetor 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-19-0154] e refuzoi si të pabazuar ankesën e tij. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi shqyrtimin urgjent të rastit të tij, duke theksuar se *“edhe DHPGJS- është në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës se si do të vendos ajo për kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës Kushtetuese.”*
14. Më 11 mars 2020, Gjykata shqyrtoi raportin paraparak të Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 7 nëntor 2018, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) kishte shpallur valën e 42-të për shitjen e asetëve, duke përfshirë edhe njësinë 37, përkatësisht *“Marketing Export Lokali Lipjan/Shitja e asetëve në valën 42”*.
16. Më 9 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës u njoftua nga AKP, se është shpallur ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar, sa i përket pjesëmarrjes në procesin e shitjes për pronën e kontestuar. Ky njoftim i AKP-së sqaronte se *“sipas Rregullave të përgjithshme të Tenderit, çmimi më i lartë i ofruar në asnjë mënyrë nuk paraqet Vendim mbi shitjen e asetit, por Vendimin për aprovimin apo refuzimin e shitjes do ta marr Bordi i Drejtorëve të AKP-së.”* Bazuar në shkresat e lëndës, menaxhmenti i AKP-së i kishte rekomanduar Bordit të Drejtorëve miratimin e shitjes për njësinë 37, në valën përkatëse të tenderimit bazuar në paragrafin 1 të nenit 14 (Aprovimi dhe Refuzimi i ofertave për asetet/subjektet e reja të tenderuara) të Rregullave të Përgjithshme të Tenderit

të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: Rregullat e Tenderit).

17. Më 3 dhjetor 2018, AKP e njoftoi parashtruesin e kërkesës për Vendimin [Nr. Ref. BD-110/17] e 23 nëntorit 2018 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së (në tekstin e mëtejshëm: Vendimi) lidhur me anulimin e tenderit për pronën e kontestuar bazuar në paragrafin 14.3 [a] të nenit 14 të Rregullave të Tenderit sepse *“çmimi i ofertës më të lartë nuk është i arsyeshëm në krahasim me çmimet mesatare të shitjeve të mëparshme”*. Njoftimi përmbante edhe udhëzimin për mjet juridik kundër Vendimit të lartcekur për anulim, përkatësisht për mundësinë e inicimit të procedurës gjyqësore pranë DHPGJS-së.
18. Më 17 janar 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në DHPGJS kundër AKP-së, duke pretenduar se Vendimi i lartcekur ishte në kundërshtim me (i) nenin 10 të Kushtetutës sepse, sipas pretendimit, arsyetimi i AKP-së se *“çmimi i ofruar për artikullin e tenderuar nuk është i arsyeshëm në krahasim me çmimet mesatare të shitjeve të mëparshme”* është në kundërshtim me ekonominë e tregut; dhe (ii) paragrafin 14.1 dhe 14.3 [a] të nenit 14 të Rregullave të Tenderit. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga DHPGJS: (i) anulimin e Vendimit [Nr. Ref. BD-110/7] të 23 nëntorit 2018 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; dhe (ii) vërtetimin se paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, është blerës i pronës së kontestuar.
19. Më 6 mars 2019, AKP paraqiti përgjigje në padi në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, duke kundërshtuar në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës me propozimin që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. AKP përmes kësaj parashtrëse, ndër të tjera, theksoi: (i) paditësi nuk i ka prezantuar faktet në kuptim të nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin në vijim: LPK); dhe (ii) nuk janë ofruar argumente ligjore për të argumentuar se Vendimi i atakuar i Bordit të Drejtorëve është i kundërligjshëm.
20. Në ndërkohë dhe përderisa padia e parashtruesit të kërkesës e 21 janarit 2019 ishte në pritje para Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, më 17 prill 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor/masës së përkohshme, përmes të cilit do i ndalohej të paditurës, përkatësisht AKP-së, shitja e pronës së kontestuar.
21. Më 19 prill 2019, AKP parashtroi përgjigje në kërkesën e parashtruesit të kërkesës për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor, duke e kundërshtuar në tërësi të njëjtin, me arsyetimin se nuk mbështetet në prova relevante dhe të besueshme e të cilat mund ta bindin gjykatën përkatëse për lëshimin e urdhrit paraprak gjyqësor, sepse nuk ka rrezik se parashtruesit të kërkesës do i shkactohej ndonjë dëm i pariparueshëm dhe i cili nuk mund të kompensohet në asnjë mënyrë.
22. Më 7 maj 2019, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktvendimin [C-I-19-0002], përmes të cilit: (i) aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për urdhër paraprak gjyqësor, duke ia ndaluar të paditurës, përkatësisht AKP-së, shitjen e pronës së kontestuar në valën e 46 të shitjes; (ii) sqaroi se urdhri përkatës është i zbatueshëm me kushtin që paditësi brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga pranimi i Aktvendimit depoziton shumën në vlerë prej një mijë

(1,000) euro për sigurimin e dëmeve të mundshme që mund të shkakttoheshin përmes urdhrit të vendosur; dhe (iii) përcaktoi se urdhri përkatës do të mbetej në fuqi deri sa DHPGJS të merr vendim përfundimtar lidhur me padinë. Përmes këtij Aktvendimi, Kolegji i Specializuar, ndër të tjerash, arsyetoi se (i) parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat e paragrafit 1 të nenit 55 (Urdhri Paraprak Gjyqësor) të Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin në vijim: Ligji për DHPGJS-në); (ii) bazuar në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 14 të Rregullave të Tenderit, Bordi i AKP-së ka të drejtën e miratimit ose jo të një shitjeje, ku refuzimi nuk është një e drejtë absolute e Bordit, prandaj duhet të ketë arsye të vlefshme; dhe (iii) theksoi se AKP-ja nuk ka dhënë ndonjë arsyetim të bazuar se përse e ka refuzuar ofertën, por vetëm në mënyrë të përgjithësuar ka kundërshtuar padinë dhe kërkesën e parashtruesit të kërkesës për urdhër paraprak gjyqësor.

23. Më 8 maj 2019, AKP e ri-tenderon pronën e kontestuar në valën e 46 të shitjes, tashmë përmes njësisë nr. 75 dhe me ditën e ofertimit të përcaktuar më 8 maj 2019.
24. Më 21 maj 2019, AKP parashtroi ankesë kundër Aktvendimit [C-I-19-0002] të 7 majit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në Kolegjin e Apelit, me pretendimin se përmes nxjerrjes së urdhrit paraprak gjyqësor janë *“shkelur dispozitat procedurale dhe materiale”*, me propozimin që (i) ankesa të aprovohet si e bazuar; (ii) të anulohet Aktvendimi [C-I-19-0002] i 7 majit 2019; dhe (iii) të refuzohet kërkesa e paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, përkitazi me urdhrin paraprak gjyqësor, si e pabazuar.
25. Më 3 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në ankesën e AKP-së pranë Kolegjit të Apelit, duke propozuar që (i) ankesa e AKP-së të refuzohet si e pabazuar; dhe (ii) të vërtetohet Aktvendimi [C-I-19-0002] i 7 majit 2019 i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.
26. Më 6 qershor 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktvendimin [AC-I-19-0065] përmes të cilit (i) aprovoi ankesën e AKP-se si të bazuar; (ii) ndryshoi Aktvendimin [C-I-19-0002] e 7 majit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së; dhe (iii) refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për nxjerrjen e urdhrit paraprak gjyqësor. Përmes këtij Aktvendimi, Kolegji i Apelit fillimisht theksoi se i njëjti nuk paragjykon zgjidhjen e meritave të padisë fillestare të parashtruesit të kërkesës. Ndërsa përkitazi me vendimmarrjen lidhur me urdhrin paraprak gjyqësor, përmes këtij Aktvendimi, Kolegji i Apelit, ndër të tjerash, arsyetoi se (i) bazuar në paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullave të Tenderit, Bordi i AKP-së ka të drejtën e miratimit ose jo të një shitjeje; (ii) anulimi i tenderit nuk mund të konsiderohet si dëm i shkaktuar sepse paragrafi 3 i nenit 14 të Rregullave të Tenderit parasheh të drejtën e Bordit të Drejtorëve për të anuluar shitjen përkatëse; (iii) duke nënshkruar të njëjtat rregulla të tenderimit, paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës është pajtuar me mundësinë e anulimit të tenderit; dhe (iv) përmes Njoftimit të 9 tetorit 2018, paditësi ishte njoftuar se ky njoftim nuk nënkuptonte shitjen e asetit sepse i njëjti duhej të miratohej ose jo përmes një vendimi të Bordit të Drejtorëve, siç është përcaktuar në Rregullat e Tenderit.

27. Më 5 gusht 2019, pasi që AKP kishte shpallur valën e re, përkatësisht valën 49 të shitjes së pronës së kontestuar, kësaj radhe të identifikuar si njësia nr. 98, me datë ofertimi të përcaktuar më 21 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë të re për nxjerrjen e urdhrit paraparak gjyqësor me arsyetimin se shitja përkatëse do të rezultonte në dëm të pariparueshëm. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu theksoi përmes kësaj kërkesë se tashmë kishte dorëzuar në Gjykatë kërkesën me nr. KI107/19, duke kontestuar kushtetutshmërinë e Aktvendimit [AC-I-19-0065] të 6 qershorit 2019 të Kolegjit të Apelit.
28. Më 13 gusht 2019, AKP-ja parashtroi përgjigje në kërkesën e dytë të parashtruesit të kërkesës për urdhrin paraparak gjyqësor, përmes të cilës kërkoi që e njëjta të refuzohet si e pabazuar pasi që tashmë përmes Aktvendimit [AC-I-19-0065] të 6 qershorit 2019 të Kolegjit të Apelit, është zgjidhur kjo çështje dhe kërkesa e paditësit për masë të përkohshme është refuzuar si e pabazuar.
29. Më 19 gusht 2019, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktvendimin [C-I-19-0002] përmes të cilit refuzoi si të pabazuar kërkesën për urdhër paraparak gjyqësor të parashtruesit të kërkesës. Ndër të tjera, në këtë Aktvendim, u theksua se *“Aktvendimi [AC-I-19-0065] i 6 qershorit 2019 i Kolegjit të Ankesave të DHPGJS (theksim i shtuar) sa i përket kësaj çështje dhe nën rrethanat e njëjta faktike është përfundimtar, andaj Kolegji i shkallës së parë në rrethana të njëjta nuk mund të dal me një vlerësim tjetër për çështjen e njëjtë për të cilën tani më është vendosur nga shkalla e dytë-Kolegji i Apelit.”*
30. Më 5 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur në Kolegjin e Apelit, duke propozuar që (i) të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar; dhe (ii) të vendoset urdhri paraparak gjyqësor në mënyrë që t'i ndalohet AKP-së ndërmarrja e çfarëdo veprimi lidhur me ri-tenderimin e pronës së kontestuar.
31. Më 24 shtator 2019, AKP-ja parashtroi përgjigje në ankesën e parashtruesit të kërkesës, përmes të cilës kundërshtoi në tërësi pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës si të pabazuara në ligjin e aplikueshëm, duke propozuar që ankesa e paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, të refuzohet si e pabazuar, duke u vërtetuar Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar.
32. Më 4 tetor 2019, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nxori Aktvendimin [AC-I-19-0154] përmes të cilit (i) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) vërtetoi Aktvendimin [C-I-19-0002] e 19 gushtit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [AC-I-19-0065] i 6 qershorit 2019 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmes të cilit është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e urdhrit paraparak gjyqësor në pronën e kontestuar, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes neneve 10 [Ekonomia], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i dispozitave

për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

34. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se (i) Aktvendimi [AC-I-19-0065] i 6 qershorit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së “*nuk i jep mbrojtje ligjore paditësit*” dhe se “*një veprim i tillë është në kundërshtim me parimet dhe liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, në kundërshtim me nenin 10, 41, 42, 53, 54*”; dhe (ii) Vendimi [Nr. Ref.BD-110/7] i 23 nëntorit 2018 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së është në kundërshtim me “*parimet bazë të tenderimit*”.
35. Parashtruesi i kërkesës në esencë konteston interpretimin e nenit 14 të Rregullave të Tenderit përmes Aktvendimit [AC-I-19-0065] të 6 qershorit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kompetenca e Bordit të Drejtorëve për anulimin e tenderëve nuk është e pakufizuar dhe në mbështetje të këtij qëndrimi i referohet edhe praktikës gjyqësore të DHPGJS-së, duke pretenduar se në nxjerrjen e Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit ka vepruar në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore, duke rezultuar kështu në shkelje të parimit të sigurisë juridike. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës i referohet (i) dy vendimeve, përkatësisht Aktvendimit [AC-I-14-0257] të 10 shtatorit 2015 dhe Aktvendimit [C-IV-14-5624] të 19 gushtit 2014, duke iu referuar “*Përmbledhjes së Jurisprudencës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, publikuar nga anëtarët e kolegjit të Apelit, vëllimi 2016, faqe 140- 144*”, të cilat nuk i ka dorëzuar në Gjykatë; dhe (ii) Aktvendimit [C-I-19-0008] të 20 gushtit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe të cilën e ka dorëzuar në Gjykatë përmes shkresës së 4 tetorit 2019.
36. Parashtruesi i kërkesës arsyeton kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme duke theksuar se (i) ri-tenderimi i pronës kontestuese do të rezultojë në dëm “*të menjëhershëm dhe të pariparueshëm për palën paditëse*”; dhe (ii) ri-tenderimi do të i jepte mundësi një pale të tretë të shpallet fituese dhe se “*një veprim i tillë për palën paditëse do të ishte një dëm i pariparueshëm ngaqë nuk do të kishte mundësi të zhdëmttohej në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar*”.
37. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të miratohet kërkesa e tij për masë të përkohshme; dhe (ii) të i ndalohet AKP-së ndërmarrja e veprimeve për ri-tenderim të pronës së kontestuar, deri në shqyrtimin merititor të kërkesës.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

(...)

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

Ligji Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 55

Urdhri paraprak gjyqësor

1. Pas parashtrimit të një kërkesë nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një urdhër paraprak gjyqësor me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet një urdhër paraprak gjyqësor. Dëmi konsiderohet si i „pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Shkresa për një urdhër paraprak gjyqësor duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë, atëherë ajo duhet t'i referohet asaj kërkesë.

Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 61

Masat e sigurimit

1. Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të

besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t’i referohet asaj kërkesë/padie.

Rregullat e Përgjithshme të Tenderit (25 Shtator 2017)

Neni 14

Aprovimi dhe refuzimi i ofertave për asetet/subjektet e reja të tenderuara

14.1 Bordi i Drejtoreve merr vendim për aprovimin e shitjeve nëse gjatë periudhës për dorëzimin e ofertave janë pranuar tre (3) e më shumë oferta.

[...]

14.3 Bordi sipas qëndrimit të tij merr vendim për refuzimin e ofertës ose anulimin e tenderit në rrethanat e paraqitura si në vijim:

a) nëse sipas qëndrimit të bordit çmimi i ofertës më të lartë nuk është i arsyeshëm në krahasim me çmimin mesatar të shitjeve të mëparshme.

b) nëse Agjencia pranon indikacione apo dyshon në ndonjë marrëveshje të fshehtë në mes të ofertuesve, apo në ndonjë aktivitet tjetër ilegal apo të parregullt të shkaktuar në lidhje me procesin e tenderimit.

(...)

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

40. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

41. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar ato të përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, pasi që është palë e autorizuar, konteston një akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktvendimin [AC-I-19-0065] e 6 qershorit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
42. Në vijim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara përmes Rregullores së saj të punës. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me pikat a), b), c) dhe d) të paragrafit 1 të rregullit 39.
43. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata i referohet gjithashtu (i) pikës b) të paragrafit 3 të r39, sipas të cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën; dhe (ii) paragrafit 2 të rregullit 39, e sipas të cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij. Vlerësimi i të parës, në rrethanat e rastit konkret është i rëndësishëm sepse Aktvendimi i kontestuar nga

parashtruesi i kërkesës ndërlidhet me kërkesën për një urdhër paraprak gjyqësor dhe rrjedhimisht hyn në fushëveprimin e “*procedurave paraprake*”. Në raste të tilla, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), në parim nuk janë të aplikueshme, përpos nëse rrethanat e rastit plotësojnë kritere të caktuara e të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës.

44. Rrjedhimisht dhe në vijim, me qëllim të përcaktimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të (i) vlerësoj nëse në rrethanat e rastit konkret, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë të aplikueshme, duke rezultuar kështu në plotësimin e kushtit të përcaktuar në pikën b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës; dhe nëse ky është rasti, (ii) shqyrtoj nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese ose jo, në përputhshmëri me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

I. Sa i përket pikës b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së Punës

45. Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e këtij rregulli si në vijim:

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

46. Siç është cekur më lart, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata duhet të vlerësoj plotësimin e kritereve të përcaktuara përmes pikës b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës, sipas të cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, sepse procedurat gjyqësore që kanë rezultuar në Aktvendimin e kontestuar për objekt shqyrtimi kanë pasur një “*masë të përkohshme*” dhe rrjedhimisht kanë të bëjnë me “*procedura paraprake*”. Mbi bazën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në parim, nuk janë të aplikueshme përkitazi me “*procedurat paraprake*”.
47. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse kjo kërkesë është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, Gjykata fillimisht do të iu referohet parimeve të përgjithshme e përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe praktika e Gjykatës për sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht në “*procedurat paraprake*” dhe më pas, do të i aplikoj të njëjtat në rrethanat e rastit konkret në mënyrë që të përcaktoj këtë aplikueshmëri.

(i) *Aplikueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në "procedurat paraprake"*

48. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parimet e përgjithshme përkitazi me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në "*procedurat paraprake*" janë përcaktuar nga Gjykata në rastet KI122/17, me parashtrues, *Ceska Exportni Banka A. S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018; dhe KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018. Parimet e përgjithshme të përcaktuara përmes këtyre dy Aktgjykimeve janë bazuar në rastin e GJENDJ-së, *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009.
49. Gjykata thekson që praktika përkatëse e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës sqaron parimet e përgjithshme mbi bazën e të cilave aplikueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në "*procedurat paraprake*" është e kufizuar. Në përcaktimin nëse rrethanat e një rasti tejkalojnë këto kufizime, përkatësisht në përcaktimin nëse rrethanat e një rasti konkret përmbushin kriteret për aplikueshmërinë e garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata duhet të aplikojë këto parime duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe kryesisht në rastin e lartcitur të GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*.
50. Në këtë aspekt, Gjykata së pari rikujton se fushëveprimi i nenit 6 të KEDNJ-së shtrihet në procedurat që përcaktojnë të "*drejtat ose detyrimet civile*". (Shih rastin e GJEDNJ-së *Ringelsen kundër Austrisë*, Aktgjykim i 22 qershorit 1972). Rrjedhimisht, për të qenë i aplikueshëm neni 6 i KEDNJ-së, rrethanat e një rasti duhet të ngërthejnë një "*kontest*" në lidhje me një "*të drejtë civile*" dhe e cila, në parim, është e përcaktuar përmes ligjeve të aplikueshme. (Shih rastin e GJENDJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 74; dhe rastin e Gjykatës KI150/16, me parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, cituar më lart, paragrafi 63).
51. Gjykata më tutje thekson se, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, "*procedurat paraprake*", si ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme/masë të sigurisë, nuk konsiderohen që përcaktojnë të "*drejta dhe detyrime civile*" dhe për këtë arsye, në parim, nuk hynë në kuadër të fushëveprimit të mbrojtjes së tillë të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 75 dhe referencat e përdorura në të).
52. Megjithatë, përmes Aktgjykimit *Micallef kundër Maltës*, GJEDNJ kishte ndryshuar dhe konsoliduar qëndrimin e saj të mëparshëm përkitazi me mos aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së në "*procedurat paraprake*". Përmes këtij Aktgjykimi, GJEDNJ (i) sqaroi se marrë parasysh rrethanat kur shumë shteteve kontraktuese përballen me një akumulim të konsiderueshëm çështjesh për shkak të mbingarkesës së sistemeve të tyre të drejtësisë, gjë që rezulton në procese të tej-zgjatura gjyqësore, vendimi përkitazi me një masë të përkohshme shpesh ndodhë të jetë i barasvlershëm me një vendim për meritat e çështjes, dhe për pasojë shumë herë ndodhë që procedurat për masa të përkohshme të vendosin përkitazi me "*detyrime dhe të drejta civile*" apo të rezultojnë në të njëjtat efekte afatgjata apo edhe të përhershme (shih

rastin e GJEDNJ-së: *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 79); dhe (ii) përcaktoi kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në “*procedurat paraprake*”. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 83-86).

53. Për sa i përket kriterëve që duhet të plotësohen në mënyrë që garancitë procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së të jenë të aplikueshme, GJEDNJ theksoi se: (i) “*procedura paraprake*” duhet të mbulojë një të drejtë “*civile*” (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 84 dhe referencat e përmendura aty); dhe (ii) kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 85 dhe referencat e përmendura aty).
54. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të vlerësojë në vijim, nëse këto dy kriterë, janë të përmbushura në rrethanat e rastit konkret, duke mundësuar për pasojë, aplikueshmërinë e garancive procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

55. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një Vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, i cili kishte anuluar tenderin në të cilin parashtruesi i kërkesës kishte ofertuar me çmimin më të lartë bazuar në autorizimet e përcaktuara përmes Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe i ndryshuar përmes amendamenteve respektive (në tekstin në vijim: Ligji për AKP-në) dhe Rregullave të Tenderit.
56. Mundësia e inicimit të procedurave gjyqësore përkitazi me këtë Vendim është po ashtu e përcaktuar përmes ligjeve dhe rregullave të cituara. Këto mjete juridike i mundësojnë parashtruesit të kërkesës kontestimin e vendimit përkitazi me të drejtën e fituar mbi pronën e kontestuar, duke rezultuar kështu në ekzistimin e një të drejte civile të përfshirë në rrethanat e rastit konkret. Për më tepër, qëllimi i urdhrit paraprak gjyqësor është që të paktën për një periudhë të caktuar kohore të sigurojë të njëjtën të drejtë që kontestohet edhe në procedurë kontestimore përkitazi me meritat e rastit. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë se kushti i parë për aplikueshmërinë e nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në procedurat përkatëse paraprake është i përmbushur. Gjykata më tej gjithashtu thekson se në rrethanat e rastit konkret, urdhri paraprak gjyqësor është përcaktues për këtë të drejtë sepse i njëjti është mekanizmi i vetëm i mundshëm për parashtruesin e kërkesës për të ndaluar shitjen e pronës së kontestuar përmes valës së re të tenderimit të shpallur nga AKP-ja, derisa DHPGJS të vendos në merita rastin e tij të iniciuar përmes padisë së 21 janarit 2019. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë se edhe kushti i dytë për aplikueshmërinë e nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në procedurat përkatëse paraprake, është i përmbushur.
57. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [C-I-19-0002] të 7 majit 2019, gjithashtu kishte vënë theks në ekzistimin e të drejtës civile dhe natyrës përcaktuese të saj në rrethanat e rastit konkret. Për më tepër, të njëjtin konstatim, Gjykata e kishte e arritur në

vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-19-0007] të 14 marsit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në rastin KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku* (në tekstin e mëtejshëm: rasti i Gjykatës KI81/19).

58. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh të drejtën civile të përfshirë në “*procedurat paraprake*”, përkatësisht urdhrin paraprak gjyqësor dhe natyrën e tij përcaktuese për të drejtën civile në fjalë, Gjykata konstaton që në rrethanat e rastit konkret, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, përmbushen kriteret për aplikueshmërinë e garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
59. Prandaj, Gjykata duhet të konstatoj se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është *rationae materie* në pajtim me Kushtetutën dhe në vijim, siç është theksuar më lart, do të vlerësojë nëse kjo kërkesë është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

II. Përkitazi me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së Punës

60. Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e këtij rregulli si në vijim:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

61. Më tej, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me procedurat e privatizimit përmes likuidimit të udhëhequra përmes AKP-së dhe kushtet e kriteret për lidhjen e kontratave të shitjes për ofertuesit përkatës. Siç është sqaruar më lart, parashtruesi i kërkesës kishte ofertuar për njësinë nr. 37 në valën e privatizimit nr. 42 dhe ishte njoftuar përmes AKP-së se (i) ishte zgjedhur si ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar; dhe se (ii) vendimi për shitjen e asetit përkatës ose jo do të merrej nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së. Më pas, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar se bazuar në pikën a) të paragrafit 3 të nenit 14 të Rregullave të Tenderit dhe sipas të cilës, Bordi i Drejtorëve mund të anulon tenderin nëse “*çmimi i ofertës më të lartë nuk është i arsyeshëm në krahasim me çmimin mesatar të shitjeve të mëparshme*”, Bordi i AKP-së kishte vendosur për të anuluar tenderin përkatës. Ky Vendim u kontestua nga parashtruesi i kërkesës në DHPGJS. Përderisa, kjo e fundit nuk ka vendosur ende për meritat e rastit, procedurat gjyqësore deri më tani dhe ato të cilat kontestohen para Gjykatës, ndërlidhen me kërkesën për urdhrin paraprak gjyqësor dhe përmes të cilit do të pamundësohej shitja e asetit të kontestuar deri në zgjidhjen e meritave të rastit. DHPGJS ka nxjerrë katër (4) vendime përkitazi me kërkesën për këtë urdhër. Kjo kërkesë fillimisht ishte miratuar nga Kolegji i Specializuar dhe më pas anuluar nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-19-0065] të 6 qershorit 2019, Aktvendim ky i cili kontestohet para Gjykatës. Kërkesa për urdhrin paraprak gjyqësor ishte përsëritur nga parashtruesi i kërkesës, kur AKP kishte shpallur valën e re të shitjes për pronën e kontestuar dhe kjo kërkesë gjithashtu ishte refuzuar edhe nga Kolegji i Specializuar dhe ai i Apelit të DHPGJS-së. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta, duke pretenduar, në esencë, se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit është nxjerrë në kundërshtim me (i)

Rregullat e Tenderit; dhe (ii) praktikën gjyqësore të DHPGJS-së, duke rezultuar për pasojë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.

62. Lidhur me pretendimet që ndërlidhen me nxjerrjen e Aktvendimit të kontestuar në kundërshtim me Ligjin për AKP-në dhe Rregullat e Tenderit, Gjykata konsideron se (i) parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve dhe interpretimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta; për më tepër që (ii) të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura para kësaj Gjykate përkitazi me urdhrin paraprak gjyqësor, janë paraqitur edhe para Kolegjit të Specializuar dhe atij të Apelit të DHPGJS-së, dhe të njëjtat i kanë shqyrtuar dhe arsyetuar ato.
63. Më hollësisht, sa i përket çështjes së parë, përkatësisht pretendimeve përkitazi me ligjshmërinë e Aktvendimit të kontestuar, Gjykata rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se çështjet e tilla, nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI99/19, me parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 37; KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60; dhe KI192/18, parashtruese e kërkesës, *Kompania Kosovare për distribuim dhe furnizim me energji, KEDS Sh.A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i datës 16 gusht 2019, paragrafi 49).
64. Gjykata gjithashtu përmes praktikës së saj gjyqësore vazhdimisht ka theksuar se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI99/19, cituar më lart, paragrafi 38; KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61; dhe KI192/18, cituar më lart, paragrafi 50).
65. Gjykata gjithashtu, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vazhdimisht ka theksuar, se në parim dhe me përjashtim të rasteve në të cilat argumentohet se "*ligji është interpretuar dhe aplikuar në mënyrë qartazi të gabuar*" duke rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesit përkatës, detyra e saj është të vlerësojë nëse procedurat para gjykatave, në tërësinë e tyre, janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

66. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk argumenton se ligji i aplikueshëm në rastin e tij është interpretuar dhe aplikuar në mënyrë qartazi të gabueshme, dhe bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata konsideron se ky nuk është rasti në rrethanat e rastit konkret. Për më tepër, Gjykata thekson se procedurat para DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit, në tërësinë e tyre, nuk ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih, në këtë kontekst, edhe rastin e GJEDNJ-së, *Shub kundër Lituanisë*, Vendim i 30 qershorit 2009).
67. Në këtë kontekst dhe më tej, Gjykata ndërlidhet me çështjen e dytë të identifikuar më lart, përkatësisht faktin që pretendimet e parashtruara para Gjykatës, janë paraqitur gjithashtu para gjykatave të rregullta, të cilat ato i kanë shqyrtuar dhe arsyetuar tashmë.
68. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyeja kryesore për refuzimin e kërkesës për urdhrin paraprak gjyqësor të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht të ndryshimit të Aktvendimit [C-I-19-002] të 7 majit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së përmes Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit ndërlidhet me faktin se (i) njoftimi për ofertuesin më të lartë nuk është njoftim për shitjen e asetit dhe se një vendim i tillë i takon Bordit të Drejtorëve të AKP-së; (ii) bazuar në paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullave të Tenderit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së, ka kompetencë anulimin e tenderit në rrethanat e përcaktuara në shkronjat a) dhe b) të tij; dhe (iii) paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, kishte dështuar të ofroj prova përmes të cilave do të vërtetonte dëmin e shkaktuar. Në kontekst të kësaj të fundit, Kolegji i Apelit arsyetoi si në vijim:

“[...ankuesi as para Kolegjit të Specializuar as para Kolegjit të Apelit nuk ka ofruar asnjë provë me të cilin do të vërtetonte dëmin që i është shkaktuar atij. Për më tepër çdo pjesëmarrës në një procedurë tenderimi e ka të qartë, sipas nenit 14.3 të Rregullave të Tenderit se vetëm Bordi i AKP-së e ka autoritetin për aprovimin e një shitje. Ndërsa shitja mund të mos aprovohet edhe për shkak të çmimit të ultë të ofruar. Prandaj përkundër pritshmërive të paditësit sidomos pas shpalljes së ofertës me çmim më të lartë, anulimi i tenderit nuk mund të konsiderohet si dëm i shkaktuar dhe për këtë nuk mund të kërkohej dëmshpërblim pikërisht për shkak të nenit 14.3 të Rregullave të Tenderit të cilat parashohin anulimin e shitjes për shkak të çmimit të pa arsyeshëm. Paditësi ka nënshkruar rregullat e tenderit dhe kjo nënkupton se ai është pajtuar edhe për mundësinë e anulimit të tenderit.”

69. Për më tepër, përmes Aktvendimit të kontestuar, Kolegji i Apelit gjithashtu adresoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me (i) kundërligjshmërinë e Vendimit të AKP-së, përkatësisht interpretimit të pikës a) të paragrafit 3 të nenit 14 të Rregullave të Tenderit nga AKP-ja; (ii) çmimin mesatar të shitjeve; dhe (iii) diskrecionin e Bordit të AKP-së përkitazi me shitjen e aseteve. Kolegji i Apelit, në këtë kontekst, sqaroi si në vijim:

“Kolegji i Apelit nuk e pranon pretendimin e paditësit se e paditura e ka aplikuar gabimisht nenin 14.3 (a) të Rregullave të Përgjithshme të Tenderit dhe as pretendimin e tij se arsyetimi i dhënë nga e paditura për anulimin e shitjes është i kundërligjshëm, nga shkak se këto pretendime paditësi ka dështuar ti provojë para Gjykatës me ndonjë provë konkrete.

Kolegji i Apelit vëren se në këtë rast nuk ka prova në dosje dhe as paditësi nuk e pohon që AKP-ja e ka anuluar shitjen e asetit në fjalë më shumë se një herë. AKP-ja me këtë veprim, ka synuar që në procedurë ri tenderuese për asetit në fjalë të nxjerr çmim më të lartë dhe kjo është një e drejtë dhe synim legjitim i saj që nuk ka bazë ligjore të kontestohet. Natyrisht në procedurën në vazhdim gjatë shqyrtimit të meritave të padisë do të vlerësohet nëse ky veprim ishte i saktë.

Paditësi në parashtrësën e tij të dorëzuar me 3 qershor 2019 me të cilën i është përgjigjur ankesës së AKP-së ka pohuar se çmimi mesatar i shitjeve për atë zonë nga shitjet e kaluara ishte 1097 euro për m2, ndërsa ai ka ofruar çmimin 1766 euro për m2. Ky pretendim i paditësit i dhënë në këtë parashtrësë nuk është vërtetuar me ndonjë provë konkrete, andaj Kolegji i Apelit nuk e ka marrë në konsideratë këtë pretendim të pa vërtetuar.

Kolegji i Apelit pohon se për situata të ngjashme ligjore siç ka vepruar e paditura në këtë rast, në jurisprudencën e tij të deritanishme, ka mbajtur të njëjtin qëndrim ligjor lidhur me diskrecionin e Bordit të AKP-së.”

70. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me interpretimin dhe zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale në rrethanat e rastit konkret.
71. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon që DHPGJS ka vepruar në kundërshtim me praktikën e vet gjyqësore në nxjerrjen Aktvendimit të kontestuar. Në këtë kontekst, dhe siç është sqaruar më lart, parashtruesi i kërkesës i referohet (i) dy vendimeve, përkatësisht Aktvendimit [AC-I-14-0257] të 10 shtatorit 2015 dhe Aktvendimit [C-IV-14-5624] të 19 gushtit 2014, duke iu referuar “Përmbledhjes së Jurisprudencës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, publikuar nga anëtarët e kolegjit të Apelit, vëllimi 2016, faqe 140- 144” dhe të cilat nuk i ka dorëzuar në Gjykatë; dhe (ii) Aktvendimit [C-I-19-0008] të 20 gushtit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe të cilën e ka dorëzuar në Gjykatë.
72. Gjykata ka vendosur parimet e përgjithshme përkitazi me mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencës në praktikën gjyqësore në kontekst të garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rastin KI35/18, me parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 6 janarit 2020 (në tekstin e mëtejshëm: rasti i Gjykatës KI35/18).
73. Përmes këtij rasti, Gjykata fillimisht ka sqaruar se është detyrë e çdo parashtruesi kërkesë të argumentoj divergjencën në praktikën përkatëse gjyqësore, pasi që nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet të i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me

ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur në mënyra të ndryshme nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë aspekt, rastin e Gjykatës KI35/18, cituar më lart, paragrafi 76).

74. Më tej, në rastin KI35/18, Gjykata ka sqaruar parimet themelore që ndërlidhen me mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencën në praktikën gjyqësore, si dhe kriteret përkatëse bazuar në të cilat, GJEDNJ vlerëson nëse divergjenca e pretenduar në praktikën gjyqësore përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, përfshirë nëse: (i) divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; (ii) ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti.
75. Në këtë rast Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në vlerësimin e 9 (nëntë) rasteve të Gjykatës Supreme të nxjerra në një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare dhe pasi kishte konstatuar se (i) kishte “*dallime të thella dhe afatgjata*”; (ii) mekanizmi i Gjykatës Supreme për harmonizimin e praktikës gjyqësore ekzistonte; por se (iii) mekanizmi i lartpërmendur nuk ishte përdorur. (Shih rastin e Gjykatës KI35/18, cituar më lart, paragrafi 70 dhe 110-111). Megjithatë, në këtë rast, Gjykata gjithashtu kishte sqaruar, se nuk mund të konstatohen “*dallime të thella dhe afatgjata*”, në krahasimin e vetëm 2 (dy) rasteve edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse. Në këtë rast, në një rrethanë të tillë e cila ngërthen vetëm një vendim i cili ishte nxjerrë në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, Gjykata nuk kishte konstatuar se ishte cenuar parimi i sigurisë juridike, duke e trajtuar një rast të tillë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si rast të izoluar. (Shih, për më shumë në këtë kontekst, paragrafët 104 dhe 114 të rastit të Gjykatës KI35/18).
76. Njëjtë, në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës ka dorëzuar në Gjykatë vetëm një vendim, përkatësisht Aktvendimin [C-I-19-0008] e 20 gushtit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke mos argumentuar gjithashtu lidhshmërinë faktike dhe juridike të dy rasteve. Për më tepër, siç u sqarua më lart, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata nuk mund të konstatojë cenim të parimit të sigurisë juridike duke u bazuar vetëm në krahasimin e dy vendimeve, sepse në rrethana të tilla, nuk mund të konstatohet se ka “*dallime të thella dhe afatgjate*” në një praktikë përkatëse gjyqësore, duke dështuar të përmbushet kështu kushti i parë i përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së për të arritur në një konstatim të tillë.
77. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton që parashtuesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të neneve 10, 41, 42, 32, 53 dhe 54 të Kushtetutës.
78. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 10 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm që nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për “*gëzimin e të drejtave dhe lirive*” që garantohen me

dispozitat e Kapitullit II [Të drejtat dhe Liritë Themelore] dhe III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës. Prandaj, këto nene në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohen nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njëres ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me “*gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut*”. (Shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës KI16/19, me parashtrues *Bejta Commerce*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 nëntorit 2019, paragrafi 42; dhe KI67/16, me parashtruese *Lumturije Voca*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, paragrafi 128).

79. Për më tepër, përkundër faktit që neni 53 i Kushtetutës është pjesë përbërëse e Kapitullit II të Kushtetutës, i njëjti vetëm përcakton që të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjykata i përmbahet këtij detyrimi kushtetues dhe ka aplikuar praktikën gjyqësore relevante të GJEDNJ-së edhe përgjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përmes këtij Aktvendimi.
80. Ndërsa, sa i përket shkeljeve të pretenduara të neneve 32, 41, 42 dhe 54 të Kushtetutës, respektivisht, Gjykata rithekson qëndrimin e saj sipas së cilit vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KI02/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 52).
81. Një qëndrim i tillë i Gjykatës, është i bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).
82. Prandaj, duke marrë parasysh sqarimet e lartcekura, Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ishin trajtuar dhe sqaruar nga gjykatat e rregullta, dhe se në tërësinë e procedurës, nuk rezulton se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo kanë interpretuar ligjin e aplikueshëm në mënyrë arbitrare, për më tepër që, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara përmes Kushtetutës dhe KEDNJ-së.
83. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe

vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI99/19, cituar më lart, paragrafi 47; dhe KI118/18, me parashtrues *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 tetorit 2019, paragrafi 48).

84. Gjykata gjithashtu thekson se Kushtetuta dhe KEDNJ nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata, në parim, të vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI99/19, cituar më lart, paragrafi 48; KI118/18, cituar më lart, paragrafi 49; dhe KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2018, paragrafi 36).
85. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
86. Prandaj, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si dhe nenet 10, 41, 42, 32, 53 e 54 të Kushtetutës.
87. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

88. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës parashtroi para saj kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme përmes së cilës do të ndalohej shitja e pronës së kontestuar deri në vendosjen meritore të çështjes nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së.
89. Gjykata tani më konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
90. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masa e Përkohshme) të Ligjit dhe pikën a) të paragrafit 4 të rregullit 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa të deklarohet e papranueshme. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI159/18, me parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 majit 2019, paragrafët 89-91; KI19/19 dhe KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi dhe*

Egzon Keka, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2), 57 dhe 59 (2), të Rregullores së punës, më 11 mars 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi